



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr.           **03/2025**

Data:                   **10 janar, 2025. Ora: 13:30**

Vendi:                   **Selia e KQZ**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi.

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana

Në takim ishin të Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

---

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 73/ 2024**

---

**3.Këshillat e KQZ**

---

---

### 3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve të rregullta me plotësim ndryshime në komunitat: Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Shtërpçë dhe Ferizaj;
- 3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për Pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV), në Vendvotime (VV) dhe Qendrën Komunale të Numërimit (QKN).

---

### 3.2. Këshilli për Çështje Ligjore

- 3.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Vushtrri

---

## 4. Të ndryshme

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim të takimit, kryetari **Radoniqi** paraqiti agjendën. Ai tha se, veç agjendës, është edhe një ftesë që ka ardhë në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë. Është një ftesë e ripërsëritur, tha ai. Ndërsa, **Ili Gashi**, tha se me 9 janar ka filluar procesi i votimit jashtë vendit, duke bërë vërejtje se KQZ e ka vështirë ta monitoroj procesin, rrjedhën e tij. Në vazhdim, z. Gashi tha se është i shqetësuar për procesin, sepse ka tendencë për tu pamundësuar, por në disa raste edhe të manipulohet! Dje, në rrjetet sociale ka pasur video sociale që ftojnë votuesit të shkojnë në adresa të caktuara, gjoja tu ndihmojnë atyre për tu regjistruar ! Këto thirrje, janë tendenca për kontaminimin e procesit të votimit në diasporë. Kinse, të ndihmohen personat, votuesit. E para, nuk lejohet të votohet nëpër kafeteri, zyra të partive, zyra të shoqatave etj. E dyta, votimi përmes postës duhet të jetë individual. E treta, nëse një votues, një bashkatdhetarë ka nevojë për ndihmë ai duhet të drejtohet në këtë institucion. Votimi është individual. Këto janë vendvotime të improvizuara, dhe ndikojnë në vullnetin e votuesit, prandaj posedimi i certifikatës së tjetrit, është vepër penale. Votimi për tjetrin, dhe ju z. kryesues duhet të bëni thirrje ex officio, prokuroria duhet të ndërmarrë masa...

Praktika të këtilla, nuk guxojmë të lejohen. Ai, demonstroi publikisht një spot ku ftohen qytetarët në një adresë të caktuar. Kjo, është vepër penale, dhe i bëjë thirrje prokurorisë të hetohet kushdo qoftë..

**Sami Kurteshi**: Nuk është shqetësim, nuk pe kuptoj. Gjithkush, duhet të ndihmohet por, fletëvotimin ta mbush me dorën e tij. Por, gjithë ata që mbushin fletëvotime, mbajnë dokumente të huaja, duhet të përjashtohen. E dëgjova: kolegu don me shpërnda një skepticizëm, një dyshim te njerëzit që askush, askujt mos t'i ndihmojë... Jam kundër ndërhyrjeve, por secili e ka për detyrë ta ndihmojë atë që ka nevojë. Subjektet politike, e kanë për detyrë të bëjnë propagandë, edhe bëjnë...?

Kolegu, ta lëshoj edhe njëherë dhe ta dëgjojmë, ta shohim ku ka vepër penale, ku është elementi i veprës penal. E kjo, është e rrezikshme, me ba propagandë, me përhapë dyshime...

**Ibrahim Selmanaj**: Shqetësimi i kolegut Gashi...! Ka dallim me ba thirrje, nuk ka nevojë askush me i ndihmue se e din edhe kënd me votue, pra ske çka ndërhyjnë me ba një pikë shtesë sepse, thjeshtë është një pikë e kontaminuar. Po, dallimi ekziston te fushata, te votimi. Edhe unë kam shqetësim sepse, kontaminohet vota, nuk e shohim...! Shqetësim duhet me pas, s nuk e kontrollojmë votën..

**Arianit Elshani**: E para, nuk ka logo të subjektit politikë që me tregue se votuesit e cilit subjekt politik janë. E dyta, ekziston rreziku real që qytetarët që kanë dëshirë me votue, që kan aplikue me votue me e mendue që kjo është hapësirë e KQZ-së. E unë po deklaroj këtu se ajo, nuk është hapësirë e KQZ-së. As nuk është thirrje e KQZ ! Është thirrje nga personat e autorizuar nga subjektet politike. Po konsideroj kështu...Kjo, duhet shpjeguar. Këtë nuk mund ta bëjë një subjekt politik. Ju e dini që KQZ nuk ka asnjë objekt të improvizuar, pavarësisht se qytetarët kanë nevojë për shpjegime, për kuptim të procedurave. Por, këtë e bën KQZ, dhe ne jemi të thirrur për këtë...

Prandaj, bëj thirrje që të ndalen këto veprime. Sepse, edhe mund të ketë orkestrime, kandidatë që përfitojnë, pra nuk jemi tu folë për një votë personale, por për një ambient ku votohet bashkërisht, ku vota bëhet publike etj.

Në këtë pikë, debatuan më tej: Sami Hamiti që tha se KQZ deri më tani e ka kryer punën e vet në mënyrë të shkëlqyeshme. Dje për shembull, në shërbimin votues janë dërguar informacione për rreth 1 orë për 30 mijë votues, ku saktë u tregohet çfarë kanë për detyrë me ba. Nuk ka nevojë

nëpër kafeteri e diku tjetër me mësue çka me ba. Institucioni ynë tregon çka me ba. Ajo, nuk a asistencë...! Animimet, orkestrimet në grup, ashiqare nënkuptohen pse bahen, po kështu lëndohet procesi, tha ndër të tjera z. Hamiti.

Pastaj, diskutoi sërish Ilir Gashi, i cili tha se këtu ka vepër penale, ka punë për prokurorinë.

Sami Kurteshi, tha se këtu po bëhen shpifje.

Alban Krasniqi, i cili lidhur me këtë pikë tha se anëtarët dhe as KQZ nuk duhet ta shpërndajë frymën e një pasigurie në proces. Por, secili të ketë ndërgjegjen e tij, si do qoftë, në aspektet teknike ia kemi dalë që ta organizojmë mirë këtë proces. Jemi në proces të votimit, dhe ne nuk duhet të lëshohemi në përhapjen e një fryme dekurajuese... E, ju duhet me pas vullnet mbas përfundimit të zgjedhjeve se janë disa divizione brenda këtij institucioni që e kanë sabotuar punën dhe vazhdojnë ta sabotojnë. Janë të paprekshëm brenda institucionet...

Ne, duhet ta shpërfaqim punën tonë, kjo është e vërteta jonë dhe ne, mendoj se ja kemi dalë deri më tani. Por, niveli i informim duhet të rritet...

**Kreshnik Radoniqi**: E hedh në votim rendin e ditës, me pikën nga KMJ. Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet.

Në vazhdim, miratohet procesverbali nr. 73/2024.

### **3. Këshillat e KQZ**

#### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve të rregullta me plotësim ndryshime në komunat: Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Shtërpçë dhe Ferizaj:

**Kreshnik Radoniqi**: Para se me vazhdue me këtë pikë, ju njoftoj se lidhur me vendimin e përbërjes së KVV-e, janë 5 ankesa në PZAP. Përgjigje, na kanë kërkuar deri në orën 4. Si mundemi ne me miratue prapë diçka që është në proces ankimore ? Unë kam rezervat e mia...

Në këtë pikë, diskutuan: Kreshnik Radoniqi, Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani.

Arianit Elshani propozoi që shqyrtohet dhe miratohet kjo pikë dhe, në kuadër të përgjigjes për PZAP-në le të dërgohet plotësim - ndryshimi i formulës së përbërjes së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve të rregullta. Dhe, të shohim se çfarë përgjigje na kthen PZAP...

( Incizimi, nuk është sistematikë, ndërpritet...)

Në vazhdim, u zhvillua debat i gjerë ku morën pjesë: Myfera Shinik, Alban Krasniqi, Gordana Llaban, Sami Hamiti, Arianit Elshani.

Në fund, u vendos që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës dhe, KQZ të presë vendimet e PZAP-së bazuar në ankimmimet e bëra.

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për Pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV), në Vendvotime (VV) dhe Qendrën Komunale të Numërimit (QKN):

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka shqyrtuar pagesat e stafit të angazhuar në QV, në VV dhe QKN-të. Ai tha se, ka një pako më të mirë pagesash bazuar në të kaluarën. Z. Elshani, paraqiti një raport të kategorizuar për stafin që, do të angazhohet në proces:

*1. Katërdhjetë euro (40) € në ditë çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;*

*2. Gjashtëdhjetë euro (60) € në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Kryesuesit e Këshillit të Vendvotimit, do të paguhet për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;*

*3. Pesëdhjetë euro (50) € në ditë, çdo Anëtar të Këshillit të Vendvotimit, në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, do të paguhet për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;*

*4. Shtatëdhjetë euro (70) € në ditë çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit në Përfaqësitë Diplomatike. Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;*

*5. Nëntëdhjetë euro (90) € në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit në vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike. Kryesuesit e Këshillit të Vendvotimit, do të paguhet për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;*

6. Tetëdhjetë euro (80) € në ditë, çdo Anëtar i Këshillit të Vendvotimit, në vendvotimet ne përfaqësitë diplomatike. Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, do të paguhen për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
7. Pesëdhjetë euro (50) € në ditë, çdo Zyrtari të Tavinës Ndhimse në Qendër të Votimit. Zyrtarët e Tavinës Ndhimse, do të paguhen për periudhën kohore prej një (1) ditësh;
8. Tridhjetë euro (30) € në ditë, çdo Anëtar Rezervë të Këshillit të Vendvotimit në Qendër të Votimit. Anëtarët Rezervë të KVV-ve, do të paguhen për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
9. Tridhjetë euro (30) € në ditë, çdo Shërbim të transportit për transportimin e materialit jo të ndjeshëm dhe të ndjeshëm zgjedhor, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
10. Katër dhjetë euro (40) € në ditë, do të paguhet, çdo Kryesues dhe Anëtar të Ekipit të numërimit në QKN. Pagesat për të gjitha kategoritë, llogariten të jenë bruto. Obligohen Zyrtarët e Ekzekutiv të KKZ-ve dhe anëtarët e KKZ, që brenda pesë (5) ditëve, pas ditës së zgjedhjeve (09.02.2025) t'i dorëzojnë listat e pagesave me saktësi në formë fizike (të nënshkruar) dhe elektronike, në SKQZ.

Me 11 vota për, miratohen

### **3. Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Vushtrri:

**Sami Hamiti**: Kemi shqyrtuar kërkesën nga kuvendi komunal i Vushtrresë. Dokumentacioni, është në rregull. Është konstatuar se pasusi i radhës ka hequr dorë nga mandati, dhe në radhë ka ardhur Ramadan Parduzi, i cili plotëson kushtet. Prandaj, rekomandon të: emërohet anëtar i kuvendit komunal në Vushtrri, nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës”, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z. Alban Bajrami.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për...?

Me 11 vota për, Ramadan Parduzi emërohet anëtar i kuvendit komunal në Vushtrri, nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës”, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z. Alban Bajrami.

#### **4.Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

##### Ri njoftim

**Kreshnik Radoniqi**: Vetëm po ju njoftoj se për këtë çështje kemi vendosur, më duket në tetor por që takimi ishte shtyrë. Por ftesa ka ardhur përsëri. Në këshill, vendosëm që Nita Mustafa dhe Argjina Misini të marrin pjesë në këtë takim in e “Rrjetit rajonal të Evropës për Fuqizimin e Grave në Zgjedhje” të organizuar nga IFES, e që mbahet në Pragë.

Takimi mbahet më 20-21 shkurt, 2025. Edhe pse kemi votuar njëherë, duhet vendim i ri, tha z. Radoniqi.

Anëtarët me 11 vota për, miratuan këtë rekomandim.

**Arianit Elshani**, tha se kanë filluar afatet. E para, afati për votimin me postë jashtë Kosovës. Votimi me postë. E dyta, edhe afati për aplikim të akreditimit të vëzhguesve. Është mirë që, sot a nesër të akreditohen vëzhguesit e partive politike. Pavarësisht, si është puna e materialeve, disnjektivëve të kemi mundësinë që ky proces të mos neglizhohet...

Diskutuan: Sami Hamiti, Qemailj Kurtis, dhe Alban Krasniqi.